



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 135

Prishtinë, më 21.1.2014, ora 14,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S2 anex

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Daut Haradinaj, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Boban Todorović.

Mungoi : Anëtarët nga VV dhe PDK ende nuk janë emëruar si zëvendësime.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.12.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligjit në parim, për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
4. Shqyrtimi i Projektligjit në parim, për mbrojtjen nga zhurma,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, ndërsa iniciativa e **Daut Haradinaj** (përkrahur nga **Boban Todorović**) për të shqyrtuar Komisioni sot Planin hapësinorë për Parkun Sharr mbeti të shqyrtohet në mbledhjen e radhës, të martën, sipas dakordimit të deputetëve pasi plotësohen afatet kohore në bazë të rregullores së Kuvendit, përndryshe z. Haradinaj potencoi rëndësinë e veçantë të miratimit të këtij plani, sidomos kur është në pyetje krijimi i bazës ligjore për investime të mundshme në këtë pjesë shumë vitale të Kosovës.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.12.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 24 dhjetor 2013 me vërejtjen e **Sevdije Lamës** rreth qëndrimit të Afërdita Berishës i cili qëndrim

duhet të evidentohet si personal e jo i Komisionit, rreth përkrahjes së praktikantes për t'ia vazhduar qëndrimin në Komision përmes UNDP.

3. Shqyrtimi i Projektligjit në parim, për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

Kryetari i Komisionit Nait Hasani falënderoi deputetin **Agim Kuleta** si përfaqësues i deputetëve nënshkrues për këtë projektligj dhe ja dha fjalën për arsyetimin e projektit. Ai kryesisht përsëriti arsyeat e cekura në projekt që Obiliqi si zonë më e ndotur në Kosovë meriton një kujdes të veçantë nga shteti duke hyrë më thellë rreth arsyrave, mirëpo kryetari cilësoi si të mjaftueshme këtë prezantim, ngase ky projekt fillimisht shkon në lexim të parë pas së cilës formohet grupi punues për shqyrtim të mëtejshëm. **Nezakete Hakaj** nga MMPH nuk kundërshtoi faktin se Obiliqi nuk meriton kujdesin, mirëpo ceku koston e lartë financiare të ligjit bashkë me Mitrovicën si dy qytete më të ndotura, i cili kosto do të bëhet problematike gjatë zbatimit. Në këtë qytet kemi ndotje të trashëguar, vazhdoi, ndaj e vetmja mundësi e reagimit të shtetit është realizimi i projekteve të filluara nga Banka Botërore për hirin dhe shumë projekte tjera, të cilat gradualisht do të stabilizojnë këtë qytet tejet të ndotur. **Kryetari Nait Hasani** shprehu mirëkuptimin rreth sqarimeve të dhëna por pyeti : ku janë beneficionet për qytetarët e Obiliqit dhe cilat janë ato, ngase në këtë qytet ka më së tepërmi : të sëmurë dhe shumë mungesa tjera, të cilat i numëroi edhe **Daut Haradinaj** dhe falënderoi Agim Kuletën me deputetët që kanë marrë këtë iniciativë për hartimin e ligjit, duke kundërshtuar qëndrimet e përfaqësuesit të MMPH dhe përkrahur pa rezervë projektligjin për Obiliqin jo vetëm si deputet por mbështetje edhe nga 13 deputet të AAK. Ky rajon meriton mbrojtje me ligj dhe beneficione nga KEK, si në punësim ashtu edhe rrym pa ndërprerje 24 orë, lirim të energjisë deri 25% për këta banorë, trajtim të veçantë të kësaj zone për ujë të pijes etj. **Salih Morina** gjithashtu potencoi deputetët Agim Kuletën (për këtë ligj) dhe Daut Haradinaj (për Zymin) të cilët kanë iniciuar ligjet e rëndësishme përkundër faktit rreth problemeve financiare, për çka duhet Kuvendi të angazhohet që në 6 mujorin e rishikimit të buxhetit, patjetër të siguroj financimin e Ligjit në fjalë. Komisioni pas leximit të parë duhet ti hyjë punës rreth arsyetimit sa më të mirë të këtij ligji, duke organizuar edhe dëgjime publike, përfundoi. **Sevdije Lama** mbështeti deputetin iniciues dhe rikujtoi për punën e komisionit rreth vizitave në Obiliq dhe KEK kur është kërkuar edhe participimi i KEK për të ndihmuar popullatën e këtij qytetit. **Kryetari** në fund falënderoi dhe sugjeroi komisionin për të rekomanduar, për çka u vendos si vijon :

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim nga mbledhja plenare, Projektligji për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

4. Shqyrtimi i Projektligjit në parim, për mbrojtjen nga zhurma

Gjithashtu edhe për këtë projektligj **kryetari Nait Hasani** arsyetoi rekomandimin për miratim sikurse për projektligjin e mëparshëm, ngase Komisioni qysh më herët ka filluar trajtimin e problematikës së Zhurmës në Kosovë, e cila po bëhet vazhdimisht problem serioz në përditshmërinë tonë. Komisioni nxori :

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim në mbledhjen plenare, Projektligji për Mbrojtjen nga zhurma.

5. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme, Komisioni :

- miratoi **Raportin më të zgjeruar për punën** e Komisionit gjatë vitit 2013, dhe
- **Plani draft i punës për vitin 2014** i cili nga Komisioni duhet të miratohet deri 29 janar 2014, të shikohet nga komisioni dhe të sugjerohen plotësimet eventuale deri në mbledhjen e radhës kur kryetari do të njoftoi komisionin me rezultatet nga takimi me mbështetësit e komisionit i cili takim do të mbahet të enjten në zyrën e tij.
- **Sevdije Lama** sugjeroi monitorimin e Ligjit të ajrit përkatësisht strategjisë, por Nait Hasani ceku arsyet e mundësive të pakta në këtë drejtim,
- Arritja e **Ligjit për Pyje** në tetor të këtij viti sipas strategjisë, sipas **Nait Hasanit** është vetëm tallje nga Qeveria, ndaj duhet të kërkoj komisioni që të mundësohet arritja e këtij projekti në prill të këtij viti, përkatësisht të organizohet takimi i komisionit dhe të ftohet ministri përkatës.

Mbledhja përfundoi në orën 15,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani